



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 73 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 8.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2016 për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna dhe të nenit 71 të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, mbështetur në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.01-020/04-6006/17 të datës 02 shkurt 2017, publikon:

K O N K U R S

Për anëtarësim në Komitetet konsultative, si vijon:

- Komitetin për Zhvillim Ekonomik
- Komitetin për Shërbime Publike, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

Përbërja:

Komitetet përbëhen nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe OJQ-ve.

Punët dhe angazhimet në Komitete kompensohen, në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve obligative (50 €), më së shumti për gjashtë mbledhje gjatë një viti fiskal.

Kompetencat:

- Japin propozime dhe sugjerime në propozim aktet e ndryshme normative.
- Japin mendime dhe ide lidhur me iniciativat e ndërmarra në fushat përkatëse nga Kryetari i Komunës, Kuvendit të Komunës dhe Komitetet e Kuvendit.
- Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës i paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme.
- Paraqesin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.
- Bëjnë hulumtime të ndryshme.

Kushtet për aplikim:

- Të jenë qytetarë të Komunës së Podujevës.
- Të jenë njohës me përvojë në fushat përkatëse apo anëtar i OJQ – së që merret me atë fushë veprimtari.
- Të kenë aftësi komunikuese dhe hulumtuese.

Afati:

Konkursi është i hapur 15 ditë nga data e publikimit.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, objekti i Komunës, zyra nr. 14.

Podujevë,
18 prill 2017



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi